



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR  
KËSHILLIN GJYQËSOR TË KOSOVËS  
PËR VITIN FINANCIAR TË PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018**

**Prishtinë, maj 2019**

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm Emine Fazliu, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Hysen Boqolli (Udhëheqës ekipi), Valbona Tolaj dhe Arta Kryeziu-Qehaja (Anëtarë të ekipit), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Shkëlqim Xhema.

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit .....	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm .....	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli .....	10
4 Qeverisja e mirë.....	17
5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	19
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA .....	22
Shtojca II: Letërkonfirmimi.....	24

## Përmbledhje e përgjithshme

Raporti përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2018, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të dt. 31/10/2018.

Auditimi është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

### Opinion i Auditorit të Përgjithshëm


#### Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

Më gjerësisht shih pjesën 2.1 të këtij raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

**Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore:**



**Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2018**

Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të KGJK-së gjatë procesit të auditimit.

# 1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përmbledhje të detajuar të gjetjeve tona të auditimit dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

## 2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm

Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV, përfshirë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

### 2.1 Opinioni i auditimit

#### Opinion i pamodifikuar

Ne kemi audituar PFV-të e Këshillit Gjyqësor të Kosovës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat vjetore financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësi dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.

#### Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

#### Çështja kyçe e auditimit

Më datën 07 gusht 2018, Qeveria e Kosovës kishte marrë vendimin Nr.18/60 për ndarjen e shtesës prej 50€ në muaj për punonjësit administrativ të KGJK-së, e cila pagesë do të ekzekutohej çdo tre muaj. Ky vendim ka hyrë në fuqi ditën e nënshkrimit dhe si i tillë nuk parasheh pagesa retroaktive.

Gjatë vitit 2018, KGJK kishte paguar shtesat në mënyrë retroaktive për tremujorin e parë dhe të dytë të vitit 2018 pa mbështetje ligjore. Shuma e paguar për këta dy tremujorët e parë të vitit 2018 ishte në vlerë prej 469,755€.

---

Arsyeja e shpërndarjes së kësaj shtesë edhe për dy tremujorët e parë të vitit sipas KGJK-së ishte marrëveshja jo formale që është bërë në mes të sindikatës të punonjësve dhe përfaqësuesve të qeverisë.

Mirëpo, gjatë auditimit tonë ne konstatuam që për vitin 2019, KGJK me qëllim të korigjimit të gabimit të pagesave të bëra në mënyrë retroaktive në vitin 2018, kishte ndaluar/pezulluar pagesat për këto shtesa deri në barazimin e kompensimit konform vendimit të Qeverisë. Bazuar në veprimet e ndërmarrura nga menaxhmenti i KGJK-së nuk kemi rekomandime për PVF-të.

### **Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV**

Drejtori i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Zyrtari Kryesor Financiar janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave të SNISA-ve, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.



## 2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Nga KGJK kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK); dhe
- Planin e Prokurimit për vitin 2018.

Lidhur me PFV-të, nuk kemi ndonjë çështje për të raportuar. Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, konsiderohet e plotë dhe e saktë në të gjitha aspektet materiale.

## 2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Nuk kemi rekomandime lidhur me PFV-të.

### 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore, pasuritë dhe detyrimet.

#### Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

KGJK në përgjithësi ka kontrollë në raport me obligimet statutores të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli kanë dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera. Megjithatë, sfidë për institucionin mbetet planifikimi jo i mirë i kërkesave për prokurim si dhe mos harmonizimi i regjistrit të pasurisë me raportin e inventarizimit.

#### 3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>1</sup>	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>23,495,024</b>	<b>29,025,054</b>	<b>27,693,591</b>	<b>19,602,402</b>	<b>19,528,929</b>
Granti i Qeverisë -Buxheti	21,941,166	26,350,099	26,047,587	19,411,317	18,872,482
Të bartura nga viti paraprak <sup>2</sup>	0	1,027,115	670,938	5,342	656,447
Të hyrat vetjake <sup>3</sup>	1,553,858	1,553,858	891,790	176,743	0
Donacionet e jashtme	0	93,982	83,276	9,000	0

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 5,530,030€. Kjo rritje është rezultat i të hyrave të bartura nga viti paraprak (2017) në total prej 1,027,115€, nga donacionet e jashtme në vlerë 93,982€ si dhe me vendimet e Qeverisë për vlerën 4,408,933€.

Në vitin 2018, KGJK ka shpenzuar 95% të buxhetit final ose 27,693,591€, me një përmirësim prej 5% në raport me vitin e kaluar. Realizimi i buxhetit është në nivel të kënaqshëm dhe se, më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

<sup>1</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

<sup>2</sup> Të hyrat vetjake nga viti paraprak (2017).

<sup>3</sup> Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>23,495,024</b>	<b>29,025,054</b>	<b>27,693,591</b>	<b>19,602,402</b>	<b>19,528,929</b>
Pagat dhe Mëditjet	17,731,599	23,584,449	22,557,422	14,622,640	14,016,443
Mallrat dhe Shërbimet	4,068,425	4,080,854	3,819,098	3,545,741	3,932,056
Shërbimet komunale	450,000	385,298	358,588	396,629	378,092
Subvencionet dhe Transferet	350,000	464,453	463,353	385,471	368,212
Investimet Kapitale	895,000	510,000	495,130	651,922	834,126

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore përfshirë arsyet dhe ndikimin që kanë pasur:

- Buxheti final në kategorinë e pagave dhe mëditjeve në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 5,852,850€. Kjo rritje vjen si rezultat i vendimeve të Qeverisë<sup>4</sup> në vlerë prej 4,750,620€, nga të hyrat vetanake të bartura nga viti i kaluar në vlerë 1,027,115€ si dhe nga donacionet e jashtme 75,115€. Në këtë kategori shpenzimi ishte 96% e buxhetit;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 12,429€. Kjo rritje është si rezultat i transferit nga shërbimet komunale në vlerë 8,000€ si dhe prej donacioneve vlera 4,429€. Shpenzimet në këtë kategori ishin 94% e buxhetit;
- Buxheti final në raport me buxhetin fillestar për shërbimet komunale ishte zvogëluar për vlerën 64,702€. Prej kësaj, me kërkesë të KGJK-së janë transferuar në mallra dhe shërbime vlera 8,000€ dhe me vendim të Qeverisë Nr.07/80 ishte deklaruar kursime në vlerë 56,702€. Ndërsa shpenzimi në raport me buxhetin ishte 93%;
- Buxheti final në raport me buxhetin fillestar kategorinë e subvencione dhe transfere kishte rritje për 114,453€. Kjo rritje ishte me vendim të Qeverisë Nr. 08/76 ku ishin transferuar 150,000€ nga investimet kapitale (Projekti ndërtimi i objektit të Gjykatës Themelore dega në Fushë Kosovë). Ndërsa zvogëlim të buxhetit kishte me vendimin e Qeverisë Nr.07/80 ku ishin deklaruar kursime në vlerë 35,547€. Në këtë kategori shpenzimet ishin afër 100% e buxhetit; dhe
- Buxhetin final në raport me buxhetin fillestar për investime kapitale ishte zvogëluar për 385,000€. Kjo kishte ndodhur me vendim të Qeverisë Nr. 08/76 ku ishin transferuar 150,000€ në subvencione dhe transfere si dhe me vendimin e Qeverisë Nr.11/79 dhe kërkesë të KGJK ishin deklaruar kursime 235,000€. Për këtë kategori shpenzimet ishin 97% e buxhetit.

## Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

<sup>4</sup> Vendimet e Qeverisë nr.02/70 - 2,695,947€, nr.08/76 - 100,000€ dhe vendimit nr.07/80 - 1,954,673€

### 3.1.1 Të hyrat dhe depozitat

Në vitin 2018 të hyrat e realizuara në KGJK ishin 7,928,116€, këto të hyra ishin realizuar nga gjobat në gjykata 3,662,986€, gjobat në trafik 1,440,575€ si dhe taksat tjera në gjykata 2,824,555€.

**Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)**

Përshkrimi	2018 Pranimet	2017 Pranimet	2016 Pranimet
<b>Të hyrat vetjake</b>	<b>7,928,116</b>	<b>7,708,641</b>	<b>8,051,611</b>
<b>Totali</b>	<b>7,928,116</b>	<b>7,708,641</b>	<b>8,051,611</b>

Me ligjin e buxhetit për vitin 2018, KGJK-së ju është lejuar shfrytëzimi i të hyrave prej 1,553,858€, ndërsa pjesa tjetër transferohet në Buxhetin e Kosovës.

Përveç të hyrave, KGJK menaxhon edhe një fond të parave nga depozitat e gjykatave të cilat njihen si llogari e mirëbesimit. Në fund të vitit llogaria e mirëbesimit ishte 4,122,700€. Prej tyre 65,617€ ishin depozitat e realizuara në vitin 2018, ndërsa pjesa tjetër prej 4,057,083€ ishte saldoja nga vitet e kaluara.

#### **Rekomandimet**

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për vitin 2018 në kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte në vlerë 23,584,449€ ndërsa realizimi ishte në vlerë 22,557,422€ apo 96% e buxhetit final. Numri i aprovuar i të punësuarave në KGJK ishte 2,271 ndërsa numri aktual në fund të vitit 2018 ishte 1,994 punonjës sipas listës së pagave.

Ne kemi rishikuar listat e pagave si dhe kemi krahasuar të dhënat e prezantuara nga Thesari, SIMFK dhe prezantimin e tyre në PFV. Po ashtu, kemi rishikuar nëse punonjësit janë paguar sipas kontratës dhe aspektin e shtesave.

#### **Rekomandimet**

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime përfshirë shërbimet komunale në vitin 2018 ishte 4,466,152€, prej tyre ishin shpenzuar 4,177,686€ apo 94% e buxhetit final. Pjesa më e madhe e shpenzimeve në këto kategori përfshijnë shpenzimet e përfaqësimit dhe avokaturës, derivateve, qirasë, komunalive, postare dhe shpenzimeve tjera.

Për këto shpenzime, ne kemi kryer testet tona dhe nuk kemi vërejtur ndonjë parregullsi.

#### **Rekomandimet**

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 3.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere në vitin 2018 ishte 464,453€, prej tyre ishin shpenzuar 463,353€, apo afërsisht 100% e buxhetit final. Kryesisht këto shpenzime kanë të bëjnë me kompensimin e të dënuarave pa bazë.

Për këto shpenzime, ne kemi kryer testet tona dhe nuk kemi vërejtur ndonjë parregullsi.

#### **Rekomandimet**

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 3.1.5 Investimet kapitale

Në vitin 2018, buxheti final për investime kapitale ishte 510,000€, ndërsa ishin shpenzuar 495,130€ apo 97% e buxhetit. Ato kryesisht kanë të bëjnë me renovimet e Gjykatave Themelore.

Për këto shpenzime, ne kemi kryer testet tona dhe nuk kemi vërejtur ndonjë parregullsi.

#### **Rekomandimet**

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 3.1.6 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale:

#### Çështja A1<sup>5</sup> - Realizimi i procedurave nga sekretariati në mungesë të kërkesave nga Gjykatat

**Gjetja** Ligji i Prokurimit Publik Nr 04/L-042 neni 28, paragrafi 10 citon që ‘autoriteti kontraktues është përgjegjës për hartimin e projektit ekzekutiv dhe i cili në mënyrë mandatore duhet t’i bashkangjitet specifikave teknike, të cilat janë pjesë e dosjes së tenderit’. Po ashtu, sipas UA 01/2015, për “Delegim të përgjegjësive në çështje të prokurimit dhe logjistik” neni-59 specifikon se Zyrtari i logjistikës nëpër gjykata përgatitë specifikacionin e nevojshëm varësisht destinacionit, e nënshkruar edhe nga eprori i tij i drejtpërdrejtë dhe e dërgon në Sekretariat tek zyrtari përgjegjës i logjistikës për kontroll dhe inicim të procedurës të prokurimit.

Gjatë testimit të procedurave të prokurimit, ne kemi vërejtur se sekretariati i KGJK-së nuk kishte kërkuar nga gjykatat kërkesa për sasi të dhe specifikat për tenderët, dhe as nuk kishte pranuar kërkesa për realizim të procedurave të prokurimit për kontratat si në vijim:

- “Mirëmbajtja dhe Renovimi i sekretariatit dhe gjykatave” në vlerë 350,734€, si dhe nuk kishte projekt ekzekutiv;
- “Furnizim me inventar për Gjykatat dhe KGJK-në” në vlerë 216,485€; dhe
- “Furnizim me material të shtypur për Gjykatat dhe KGJK-në” në vlerë 222,093€.

Për këto kontrata, sekretariati i KGJK-së kishte realizuar procedura të prokurimit pa pranuar kërkesa të njëjësive të Gjykatave themelore të Kosovës, por vetëm sipas planifikimit të sasive nga sekretariati dhe bazuar në kontratat paraprake.

**Rreziku** Realizimi i procedurave të prokurimit duke mos marr parasysh nevojat dhe kërkesat e gjykatave mund të rezultojë me kontrata apo shpenzime jo të planifikuara mirë.

**Rekomandimi A1** Kryesuesi i KGJK-së të siguroj që para fillimit të procedurave të prokurimit janë kërkuar dhe pranuar kërkesa të miratuara nga Gjykatat për nevojat reale të tyre.

<sup>5</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C - nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura

## 3.2 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Pasuria kapitale mbi 1,000€ e prezantuar në PVF ishte në vlerë 15,889,621€, pasuritë nën 1,000€ ishin në vlerën 1,825,179€ ndërsa stoqet 205,416€.

Ne testuam blerjet e vitit 2018, rregullsinë në regjistrimin e pasurisë, si edhe ekzaminimin fizik për të verifikuar ekzistencën e pasurive.

Lidhur me këtë, ne identifikuam dobësinë si në vijim:

### Çështja C1 - Mungesa e harmonizimit të regjistrimit të pasurive me raportet e inventarizimit

**Gjetja** Rregullorja Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurive jo Financiare, neni 4 parasheh, që ZKA është përgjegjës për aprovimin e rregullave dhe procedurave të brendshme për evidencën, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurive jo – financiare, ndërsa neni 19 përcakton që të bëhet krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare. Kjo duhet të bëhet para përgatitjes së PFV.

Në vitin 2018, KGJK nuk kishte bërë harmonizimin e regjistrave të pasurive me raportet e inventarizimit, për të konfirmuar gjendjen e plotësisë dhe saktësisë së regjistrave të pasurive. Për më tepër në katër gjykata<sup>6</sup> nuk ishin bërë raport të inventarizimit.

Kjo ka ndodhur si pasojë e mungesës së kontrolleve të duhura nga sekretariati dhe gjykatat për të siguruar harmonizimin dhe kryerjen e plotë të procesit të inventarizimit.

**Rreziku** Mos kryerja e plotë e inventarizimit dhe mos harmonizimi i regjistrave të pasurisë me raportet e inventarizimit para përgatitjes së PFV mund të rezultojë që shpalosja e tyre në PFV të mos jetë e plotë dhe e saktë.

**Rekomandimi C1** Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës të sigurohet që para përgatitjes së PFV është bërë inventarizimi i plotë duke u harmonizuar me regjistrat përkatës.

<sup>6</sup> Gjykata e Apelit, Gjykatat Themelore në Prishtinë, Pejë dhe Ferizaj

### 3.3 Të arkëtueshmet

Pasqyra e llogarive të arkëtueshme në fund të vitit 2018 ishte 140,383€. Këto LL/A përbëhen nga vendimet e gjykatave të cilat janë të pa realizuara deri në fund të vitit 2018 dhe si të tilla janë bartur për t'u inkasuar në vitin 2019.

Gjatë testimit të tyre ne nuk kemi hasur në ndonjë çështje të rëndësishme për tu raportuar.

#### **Rekomandimet**

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 3.4 Obligimet e papaguara dhe detyrimet kontingjente

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2018 ishte 141,482€. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2019. Krahasuar me obligimet e papaguara nga viti i kaluar, ku obligimet e papaguara ishin 376,454€ në këtë vit kemi zvogëlim për 62%.

Ndërsa, detyrimet kontingjente në fund të vitit 2018 ishin 11,133,890€. Këto janë detyrime të mundshme në të ardhmen nga padit e bëra nga personat të cilët kanë qenë në burgim, paraburgim apo burg shtëpiak dhe janë liruar me vendim të gjykatës.

Lidhur me këto, ne nuk kemi hasur në ndonjë çështje të rëndësishme për tu raportuar .

#### **Rekomandimet**

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.



## 4 Qeverisja e mirë

Qeverisja e mirë përfshinë parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontroleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisja e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit, pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, e të cilat i dorëzojnë në Ministrinë e Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

### Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit, për të cilat KGJK kishte progres në zbatimin e rekomandimeve nga viteve të kaluara. Po ashtu, pyetësi i vetëvlerësimit ishte përfunduar me kohë si kërkesë ligjore e paraparë me rregullat e MFK-së.

Për të vendosur një rregull në aspektin e punës së gjyqësorit KGJK-së është duke u zbatuar projekti SMIL që akoma është në fazën e hershme (fillestare) të zbatimit, pritjet janë që ky projekt të siguron rritjen e efikasitetit në zgjidhjen e rasteve gjyqësore dhe me këtë në avancimin e standardit të lirive dhe të drejtave të njeriut, për tu gjykuar në kohën sa më të shpejt/arsyeshme që është dhe kërkesë kushtetuese.

## 4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB), përbëhet nga Drejtor i NJAB-së dhe tre auditorëve. NJAB kishte të aprovuar planin vjetor strategjik dhe planin vjetor të punës për vitin 2018 ku kishin planifikuar dhe kryer shtatë auditime të rregullta.

### Çështja B1- Mungesa e komitetit të auditimit

**Gjetja** Ligji për kontroll të brendshëm të financave publike nr. 06/L-021 neni 20 përcakton rregullat për themelimin e komitetit të auditimit (KA), i cili është organ i pavarur këshillëdhënës për udhëheqësin e subjektit të sektorit publik, dhe mbështetës për auditorët e brendshëm.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës nuk ka të themeluar komitetin e auditimit përkundër rekomandimit tonë nga viti i kaluar. Mos themelimi i KA sipas KGJK-së, ishte jo interesimi i zyrtarëve për të qenë pjesë e komitetit, si pasojë e mos kompensimit të tyre.

**Rreziku** Mos funksionimi i KA rezulton me mos shqyrtim të raporteve të NJAB që rrit rrezikun që menaxhmenti të mos jetë i informuar për të ndërmarrë masat adekuate për çështjet e ngritura nga NJAB.

**Rekomandimi B1** Kryesuesi i KGJK-së dhe Drejtori i SKGJK-së duhet të sigurojë themelimin e komitetit të auditimit.

## 4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Në kuadër të KGJK-së operojnë: Sekretariati i KGJK-së (SKGJK), shtatë Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit, Gjykata Supreme, Dhoma e Posaçme, Njësia e Shqyrtimit të Performances dhe Zyra e Prokurorit Disiplinor. PVF-të e të gjitha njësive konsolidohen në PVF-të e KGJK-së dhe të konsoliduara dërgohen në Thesar si një tërësi. Njësitë e KGJK-së kanë përgjegjësitë e tyre të ndara nga SKGJK të bartura me Udhëzimin Administrativ 01/2015.

Procesi i raportimit të brendshëm në KGJK-së funksionon në nivel të kënaqshëm sipas strukturës organizative. Për detaje të mënyrës së funksionimit të kontrolleve të brendshme dhe menaxhimit është vlerësuar në kapitujt dhe nënkapitujt e këtij raporti.

## 5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të vitit 2017 ka rezultuar me 10 rekomandime. Menaxhmenti i KGJK-së ka ndërmarrë veprime për t'i adresuar çështjet e ngritura.

Deri në fund të auditimit për vitin 2018, shtatë rekomandime ishin zbatuar, një ishte pjesërisht, një i përsëritur dhe një konsiderohet i mbyllur. Për një përkrahje më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë trajtuar ato, shih tabelën 4.

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2018

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2017	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PFV	Drejtori i SKGJK duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i adresuar shkaqet në Theksim të Çështjes së opinionit të auditimit dhe para se pasqyrat të dërgohen në MF, ato t'i nënshtrohen një rishikimi gjithëpërfshirës në lidhje me përmbajtjen dhe saktësinë e tyre, me theks të veçantë shpalosjen e detyrimeve kontingjente.	KGJK ka shpalosur detyrimet kontingjente në PFV.	I zbatuar.
2	PFV	Drejtori i SKGJK duhet të shtoj kontrollet gjatë planifikimeve buxhetore, në mënyrë që të eliminohen gabimet në klasifikimin e shpenzimeve përmes sigurimit të buxhetimit/shpenzimit dhe raportim të drejtë të tyre.	Nuk ka pasur keq klasifikim në mes të kategorive.	I zbatuar.
3	Pagat dhe shtesat	Kryesuesi i KGJK dhe Drejtori i SKGJK, duhet të siguroj se të gjitha shpenzimet në lidhje me kompensimin e takimeve të anëtarëve në këshill dhe komisione të jenë të dokumentuara dhe në pajtim me UA në fuqi.	Nuk kemi hasur të pagesave në kundërshtim më UA.	I zbatuar.
4	Pagat dhe shtesat	Kryesuesi i KGJK, Drejtori i SKGJK dhe Kryetarët e gjykatave përkatëse, duhet të sigurojë zhvillimin e procedurave të rekrutimit, që këto pozita të plotësohen me kontrata të rregullta. Kohëzgjatja e funksionit	Nuk kemi hasur në raste të tilla.	I zbatuar.

		si U.D të mos jetë më e gjatë se periudha e përcaktuar ligjore.		
5	Pagat dhe shtesat	Kryesuesi i KGJK, Drejtori i SKGJK-së dhe Kryetarët e gjykatave përkatëse, duhet të siguroj që vendimet e nxjerra nga Qeveria për stimulimin financiarë të gjyqtarëve për krime të rënda të zbatohen në tërësi vetëm për numrin e lejuar të tyre.	Nuk ka pasur vendime të tilla nga qeveria në 2018.	I zbatuar.
6	Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Kryesuesi i KGJK, Drejtori i SKGJK dhe Kryetarët e gjykatave përkatëse, duhet të siguroj se marrëveshjet për shërbime të veçanta përdoren vetëm për qëllimin e caktuar, planifikohen drejtë dhe bëhen në pajtim me kërkesat ligjore në fuqi.	Nuk kemi hasur raste të tilla në 2018.	I zbatuar.
7	Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryesuesi i KGJK-së, Drejtori i SKGJK dhe Kryetarët e gjykatave përkatëse duhet t'i rishikoj kontrollet ekzistuese për të siguruar menaxhim efikas dhe regjistrimin e gjithë pasurive, në mënyrë që të siguroj largimin e pasurive jashtë përdorimit sipas vlerësimeve të komisionit përkatës dhe të harmonizojnë raportet e vlerësimit dhe inventarizimit të cilat i paraprijnë paraqitjes së të dhënave të sakta të pasurive në PFV. Në këtë aspekt të ndërmerr veprime konkrete për funksionalizimin e sistemit të e-pasurisë që të gjitha pasuritë nën 1,000€ të regjistrohen në këtë sistem.	Në vitin 2018, sistemi e-pasuria ishte vënë në funksion, duke regjistruara blerjet e theksuara në raportin e vitit 2017. Megjithatë në vitin 2018, procesi i inventarizimit nuk ishte i plotë dhe nuk ishte bërë harmonizim me regjistrin e pasurive.	Pjesërisht i zbatuar.
8	Progresi në zbatimin e rekomandimeve	Kryesuesi i KGJK-së, Drejtori i SKGJK-së dhe Kryetarët e gjykatave përkatëse, duhet të sigurojë që plani i veprimit rishikohet, duke analizuar shkaqet e rekomandimeve të pazbatuara, të përcaktojë një afat të ri kohor, si dhe mekanizma llogaridhënës ndaj të gjithë personave përgjegjës të ngarkuar për zbatimin e rekomandimeve. Në fokus fillestar duhet të jenë fushat e një rëndësie më të madhe.	KGJK ka përcaktuar si koordinator për përcjelljen e implementimeve të rekomandimeve Udhëheqësin e departamenti të financave, i cili kishte bërë raporte për progresin e rekomandimeve në periudha mujore.	Rekomandim i mbyllur.

		Zbatimi i këtij plani duhet të monitorohet në vazhdimësi.		
9	Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryesuesi i KGJK-së dhe Drejtori i SKGJK-së duhet të sigurojë themelimin e komitetit të auditimit.	Edhe në vitin 2018 KGJK nuk ka themeluar komitetin e auditimit.	I përsëritur.
10	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut	Kryesuesi i KGJK-së dhe Drejtori i SKGJK-së duhet të sigurojë që hartimi i regjistrit të rreziqeve të jetë në përputhje me objektivat, të delegohet përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut tek një zyrtar përkatës i cili do të siguroj monitorim dhe raportim në baza të rregullta mbi rreziqet.	KGJ ka përgatitur listën e rreziqeve bazuar në kërkesat e MFK-së dhe ka rishikuar apo monitoruar atë gjatë vitit 2018.	I zbatuar.
Nr	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2018		
1	Çështje të përbashkëta	Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës të siguroj që para fillimit të procedurave të prokurimit janë kërkuar dhe pranuar kërkesa të miratuara nga Gjykatat për nevojat reale të tyre.		
2	Pasuritë jo financiare	Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës të sigurohet që para përgatitjes së PFV është bërë inventarizimi i plotë duke u harmonizuar me regjistrat përkatës.		
3	Auditimi i brendshëm	Kryesuesi i KGJK-së dhe Drejtori i SKGJK-së duhet të sigurojë themelimin e komitetit të auditimit.		

## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

### Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të

---

cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

*Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit*

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.



## Shtojca II: Letërkonfirmimi



### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2018 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturën dhe rekomandimin dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimit, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tij.

z. Skender Çoçaj .....

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Data: 23 Maj 2019, Prishtinë

